

**MARENGLLEN VERLI****KONGRESI ARSIMOR I ELBASANIT DHE THEMELIMI  
I SHKOLLËS NORMALE NË BURIMET DIPLOMATIKE  
AUSTRO-HUNGAREZE**

Kongresi i Elbasanit është njohur si një ngjarje e rëndësishme në historinë tonë kombëtare, veçanërisht në historinë e arsimit kombëtar. Historiografia shqiptare e ka trajtuar këtë temë dhe ka evidentuar specifikat dhe vlerat e këtij kongresi, duke nënvizuar kujdesin e atdhetarëve të kohës për ta shpëtuar arsimin shqip nga goditjet e xhonturqve, për organizimin e rrjetit të shkollave shqipe, drejtimin e përqendruar të tyre nga një institucion kombëtar, sigurimin e mjeteve financiare për mbajtjen e tyre etj.

Por, edhe pse Kongresi i Elbasanit është një ngjarje e trajtuar nga historiografia, detajet lidhur me situatën e mbajtjes së tij, vështirësitë, arritjet, diferencat në përfaqësimin e trevave të ndryshme shqiptare etj., ka ende vend të bëhen objekt hulumtimesh e analizash, veçanërisht kur të gjitha këto mund të shihen nga këndvështrimi i diplomatëve të huaj. Në studimin e mëposhtëm objekt për temën është bërë dokumentacioni diplomatik austro-hungarez i kohës. Falë përhapjes në shumë qendra të viseve shqiptare të diplomatëve të Perandorisë Habsburge, kualifikimit apo profesionalizmit të tyre të lartë, por edhe mjeteve të konsiderueshme monetare që kishin në dispozicion, të cilat përdorëshin edhe për të joshur informatorë cilësorë, i japin vlerë të veçantë dokumentacionit konsullor të Vjenës.

Qysh në fillim duhet thënë se periudha mbi 30-vjeçare, që ndan dy momente të rëndësishme në përpjekjet e elitës së re politike të Perandorisë Osmane, për ta shpëtuar nga shembja dhe për ta modernizuar këtë ngrehinë shtetërore multinacionale të rrënuar, sikurse konstatonin edhe diplomatët e Austro-Hungarisë, i gjeti tepër aktivë edhe shqiptarët, që llogarisnin perspektivën e tyre, por ende të fragmentuar në qëndrimet e pikëpamjet e tyre.

Në dekadat e fundit të shek. XIX, në kohën e përpjekjeve të vezirit vizionar Mithat Pashës, për ta bërë Perandorinë me kushtetutë dhe në

vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, elita politike shqiptare ishte grupuar në tre orientime kryesore, pikërisht në ato të atdhetarëve të moderuar e radikalë dhe në pasuesit e politikës konservatore të Portës së Lartë. Tre dekada më vonë, fragmentarizimi mbetej ende, veçse me një farë riorientimi. Nuk kishin lëvizur nga vendi pasuesit e politikës së vjetër të Sulltan Hamidit, por pjesëmarrja masive dhe roli vendimtar i shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk të verës së vitit 1908, që i dha fund absolutizmit, tregoi se shqiptarët masivisht ishin për ndryshime. Shumë nga të moderuarit prej elitës politike shqiptare shpresuan dhe i mbështetën xhonturqit përderisa politika e tyre e “panosmanizmit” (që pengonte decentralizimin, ndërkohë që s’mund ta mbanin të centralizuar Perandorinë me dhunë) dhe koniunktura e disfavorshme ndërkombëtare për Perandorinë (kur jo vetëm fqinjët e saj të vegjël, por edhe Fuqitë e Mëdha nuk ishin më për statuskuonë në Ballkan), përcaktuan që grupimet e atdhetarëve, të cilët kërkonin autonominë e vilajeteve shqipare dhe gjithë të drejtat kombëtare e njerëzore, sipas shembujve të shteteve të përparuara, të rriteshin dhe, brenda një periudhe të shkurtër, të dominonin situatën.

Në këtë terren, në të cilin xhonturqit ishin të detyruar të toleronin, në viset shqiptare ndodhën ato ngjarje të mëdha, të cilat, në politikë çuan nga përplasjet në parlament deri te katër konfrontimet masive të armatosura të viteve 1909, 1910, 1911, 1912, kurse në përpjekjet për zhvillimin e arsimit dhe kulturës kombëtare dhe përgjithësisht të emancipimit kombëtar, siguruan ato arritje që vetëm për një vit, në harkun kohor të 1909-1910, sollën atë hap cilësor të paarritur nga Rilindja Kombëtare apo Lëvizja Kombëtare Shqiptare në të gjithë dhjetëvjeçarët e mëparshëm<sup>1</sup>.

Hapja e Shkollës Pedagogjike apo Normales së Elbasanit, shkollës së parë të mesme kombëtare shqiptare, në dhjetor 1909, e cila erdhi si fryt i vendimeve të Kongresit të Elbasanit të shtatorit të po atij viti (2-8 shtator 1909), ngritja e një vargu shkollash të tjera, veçanërisht shkollash fillore dhe orientimi i përpjekjeve për futjen ligjore të gjuhës shqipe në të gjitha shkollat e ndjekura nga nxënësit shqiptarë e të financuara nga qeveria, mandej krijimi në Korçë i shoqërisë “Përparimi” për financimin, administrimin dhe pajisjen me literaturën dhe mjetet e nevojshme të

---

<sup>1</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. II Tiranë: “Toena”, 2002, Kreu V, VI, VII, VIII, IX, X.

shkollave shqipe, të gjithë këto hapa në vijim të zbatimit të vendimeve të 35 delegatëve (përfaqësues të klubeve e shoqërive shqiptare) të Kongresit në fjalë, por edhe arritje të tjera në dy Kongrese të Manastirit (14-22.XI.1908 dhe 2-3.IV.1910) për problemin e alfabetit të shqipes, si edhe në një varg tubimesh të tjera ku atdhetarët thanë fjalën e tyre, ishin yjet e asaj galaktike, që ndriçuan rrugën drejt përvijimit të identitetit dhe zhvillimit arsimor e kulturor, drejt pjekurisë për të realizuar sipas situatave të afërta autonominë ose pavarësinë kombëtare.

Hapat e dukshëm të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare natyrisht ndiqeshin me vëmendje në Stamboll dhe në gjithë kancelaritë e monarkive ballkanike, por ato monitoroheshin me seriozitetin më të madh edhe nga Fuqitë e Mëdha me interesa në rajon, që përpiqeshin të gjitha të ndikonin në të mirë të interesave të tyre respektive.

Ndër Fuqitë e Mëdha të interesuara posaçërisht për rajonin dhe rolin e shqiptarëve aty, spikaste Perandoria Austro-Hungaraze, e cila, sikurse u theksua më lart, informohej e përpiqej të ndikonte rregullisht përmes diplomatëve të saj të akredituar në disa qendra të viseve shqiptare, por edhe të Ballkanit në përgjithësi, veçanërisht në territoret e Perandorisë Osmane, si konsujt Kral, Kraus, Bilinski, Posfai, Adamkieviç, relatori Pollanz, ambasadori në Stamboll Eduard Otto, etj. Edhe pse vlerësimet dhe ndërhyrjet e konsujve të Vjenës dhe të kryediplomatit, ministrit të Jashtëm Erental, reflektonin vlerësime e hapa në përputhje me politikën zyrtare të shtetit të vet, veprimtaria dhe informacioni i tyre, në rastin konkret për situatën në Ballkan e më gjerë si edhe për ngjarjet, që i paraprinë hapjes së Normales së Elbasanit dhe fillimit të punës së kësaj shkolle, janë mjaft interesante<sup>2</sup>.

Përmes të dhënave autentike të diplomatëve austro-hungarezë në terrenin shqiptar<sup>3</sup>, mësojmë se Ballplatzi jo vetëm informohej për situatën

---

<sup>2</sup> *Arkivi i Instituti të Historisë* (më tej: *AIH*), Arkivi i Vjenës, Dokumente diplomatike të periudhës 1908-1909.

<sup>3</sup> *Po aty*, Vj. 19.2.255. Shkresë Nr.65. Ref. I, përcjellë pas 21 shtatorit 1909, ambasadave të Austro-Hungarisë dhe misionëve të saj konsullorë në Ballkan me informacion për Kongresin Shqiptar të Elbasanit. Austro-Hungaria kishte misionë konsullorë në Vlorë, Janinë, Manastir, Selanik, Shkup, Prizren, Mitrovicë dhe ambasadë në Stamboll, të cilat kombinonin marrjen dhe dhënien e informacioneve me Vjenën dhe kjo informacionet më të rëndësishme i çonte deri në përfaqësitë e saj diplomatike në Beograd, Bukuresht, Sofje, Athinë, Cetinë, Paris, Londër, Berlin, San Peterburg, Romë, Madrid, Washington, Tokio etj.

në viset shqiptare por, në kuadër të kujdesit për të mos u kompromentuar në veprime që do të sillnin reagimin e xhonturqve e të Romës rivale, gjithashtu edhe të Fuqive të tjera dhe të forcave të terrenit ballkanas<sup>4</sup>, e kishte shfrytëzuar periudhën midis Kongresit të Manastirit dhe atij të Elbasanit për të nxitur rrafshimin e kontradiktave në radhët e parisë shqiptare ku i dëgjohej fjala lidhur me çështjet e unifikimit të alfabetit të shqipes. Njëkohësisht, Vjena interesohej për nxitjen e kujdesshme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, për zhvillimin e arsimit e kulturës kombëtare, për të kapërcyer pengesat e ndryshme që asaj i dilnin përpara, si edhe, natyrisht, për të konsoliduar radhët e lobit proaustriak ndër shqiptarët<sup>5</sup>.

Ngjarjet që lidhen me Kongresin Shqiptar të Elbasanit (të 2-8 shtatorit 1909) diplomacia e Austro-Hungarisë i përcolli me shumë vëmendje. Në disa raporte shumë të hollësishme, ku spikat ai i datës 10 shtator 1909, dërguar prej konsullit Posfai, nga Manastiri, ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, kontit Erental, vetëm dy ditë pasi kish mbyllur punimet Kongresi, thuhet ndër të tjera se “Kongresi Shqiptar i Elbasanit, që pritej prej një kohe të gjatë.... i zhvilloi punimet..... dhe në të morën pjesë 35 delegatë<sup>6</sup>, nga të cilët 6 të krishterë dhe një delegatë e

<sup>4</sup> *Po aty*. Njoftim i 14 shtatorit 1909 dërguar nga Tirana e Durrësi prej V. Pollanz në emër të nënkonsullit Halla, për ministrin e Punëve të Jashtme Alois fon, Vjenë përcjellë pas 21 shtatorit ambasadave të Austro-Hungarisë të akredituara në shtete të ndryshme të botës. Shih edhe *AIH*, Vj. 19.14.1485, Filmi A-753, foto I-633, Raport konfidencial dërguar më 10 shtator 1909 nga Manastiri kontit Erental në Vjenë, ministër i Punëve të Jashtme të A-H; *Po aty*, Vj. 19.2.252. Telegram, dt. 30 gusht 1909 i ministrit Erental nga Vjena për ambasadorin e A-H në Stamboll, Markgraf, Pallaviçinin; *Po aty*, Vj. 19.2.253, Nr. 49/sekret, Janinë 1 shtator 1909. Relacion i konsullit të A-H, Bilinski, për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, Alois fon Erental.

<sup>5</sup> *Po aty*, Vj. 19.14.1489, Raport nga Vlora i konsullit Kraus, i dt. 18 shtator 1909, për Erentalin në Vjenë; *Po aty*, Vj. 19.6.608, Raport i dt. 18 shtator 1909 i konsullit Adamkieviç nga Shkupi drejtuar Erentalit në Vjenë; *Po aty*, Vj. 19.7.740. Raport nga Shkodra, dt. 20 shtator 1909, i konsullit Kral për ambasadorin Eduard Otto në Stamboll.

<sup>6</sup> *Po aty*, Vj. 19.14.1485, Filmi A-753, foto I-633. Raport konfidencial dërguar më 10 shtator 1909 nga Manastiri, kontit Erental, ministër i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë. *Delegatët e Kongresit të Elbasanit*:

Elbasan, klubi “Vëllazëria” Dervish Bej (Biçaku), Qamil Feza

Elbasan, klubi “Bashkimi”, Emin Haxhi Ademi, Taqi Buda

grave shqiptare të Manastirit, e cila në fakt nuk u lejua të merrte pjesë në bisedime<sup>7</sup>. Në shtojcën e parë që shoqëronte raportin, i cili përmbante emrat e shumë veprimtarëve të njohur të Lëvizjes Kombëtare shënoheshin emrat e delegatëve elbasanas, Dervish bej Biçakut e Qamil Fejzës për klubin “Vëllazëria”, Emin Haxhi Ademit e Taqi Budës

Elbasan, shoqëria “Afërdita”, Simon Shuteriqi, Josif Haxhimima  
 Strugë, Abdulla Aga, Rushit Ahmeti  
 Starovë, klubi “Bashkimi”, Selman Blloshmi, Sulejman Leka  
 Ohër, klubi “Bashkimi”, Hamdi Ohri, Irfan Ohri  
 Korçë, klubi “Ditura”, Idhomene Kosturi, Orhan Pojani  
 Korçë, Misioni Amerikan, Grigor Cilka, Sevasti Qiriazi  
 Manastir klubi “Bashkimi” Gjergj Qiriazi  
 Dibër, klubi “Bashkimi”, Gjergj Qiriazi  
 Follorinë klubi “Bashkimi”, Gjergj Qiriazi  
 Kozhanë, klubi “Vëllaznia”, Abdurrahman Kavaja  
 Karaferia, klubi “Bashkimi”, Midhat bej Frashëri  
 Janinë, klubi “Bashkimi”, Midhat bej Frashëri  
 Berat, klubi “Bashkimi” Qemal Vrioni, Kahreman beu Vrioni.  
 Filat, klubi “Bashkimi” Midhat bej Frashëri, Osman efendi Djuraja  
 Gjirokastrë, klubi “Drita” Andrea Ikonomi, Thoma Papapano  
 Leskovik, klubi “Bashkimi” Haxhi Bajram bej, Teki Bej  
 Përmet, klubi “Bashkimi” Haxhi Bajram Beu, Teki Beu  
 Skrapar, klubi “Bashkimi”, Abdulla bej Koprencka  
 Frashër, klubi “Bashkimi”, Midhat bej Frashri  
 Gramsh, klubi “Bashkimi”, Telha bej  
 Tiranë, Refik Toptani, Afëz Ibrahim Dalliu  
 Tiranë, Misioni Amerikan, Kristo Dako  
 Durrës, Jahja Efendiu, Mihal Djureskovik, Dom Nikollë Kaçorri  
 Selanik, klubi “Mirëbërësia” Midhat bej Frashri, Osman Efendi Djuraja  
 Jenixhe Vardar, Midhat bej Frashëri  
 Shkup, klubi “Bashkimi”, Midhat bej Frashëri, Osman efendi Djuraja.

Në *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, f. 415, ndër emrat e delegatëve shënohet edhe Ahmet Dakli, i cili nuk figuron në dokumentin e sipërpërmendur. Gjithashtu për Strugën shënohet Abdulla Rushit Ahmeti, ndërkohë që në dokument figurojnë dy persona Abdulla Aga dhe Rushit Ahmeti. Sipas dokumentit figurojnë 33 pjesëmarrës. Në se shtohet Ahmet Dakli për Elbasanin, tregtari Mahmut Fortuzi për Tiranën dhe përfaqësuesi i Strugës është një person Abdulla Rushit Ahmeti dhe jo dy persona, atëherë do të bëhej fjalë për 35 pjesëmarrës në Kongres që përfaqësonin 45 mandate delegatësh. Nëse do të kishim marrë pjesë edhe 5 delegatët e Vlorës, do të bëhej fjalë për 50 mandate delegatësh.

<sup>7</sup> Po aty, Vj. 19.2.255, Raport dt. 14 shtator 1909 nga Pollanz (Tiranë-Durrës).

(Dhimitër Budës) për klubin “Bashkimi” dhe Simon Shuteriqit e Josif Haxhi Mimës për shoqërinë “Afërdita”<sup>8</sup>.

Në disa raporte nënvizohet mungesa e pjesëmarrjes masive në Kongres e delegatëve nga Shqipëria e Veriut dhe argumentohet se apatia e vërejtur në këto vise e kishte burimin në përçarjen e krijuar veçanërisht me propagandë nga xhonturqit, kurse në rastin e Vlorës nga dhuna e raprezaljet që ishin ushtruar mbi parinë e atjeshme<sup>9</sup>. Për pasojë nga gjithë vilajeti i Shkodrës, relatonte V. Pollanz nga Durrësi, morrën pjesë vetëm 6 delegatë (Refik bej Toptani, Hoxha Hafëz Ibrahim Dalliu dhe tregtari Mahmut Fortuzi për Tiranën dhe me vonesë Dom Nikollë Kaçorri, tregtari Jahja Efendiu dhe Mihal Gjurashkoviçi), kurse pesë vlonjatët, të kërkuar për t’u arrestuar, (Halim bej Risiha, Qemal bej Risiha, Hamza Isa Efendiu, Hasan aga Sharra, Zeno aga Sharra) shkuan por u larguan menjëherë nga Elbasani<sup>10</sup>.

Në raportin e 10 shtatorit 1909 të konsullit të Manastirit Posfai, precizohet se Kongresi u hap nga shehu bektashi Haxhi Aliu dhe, pas kësaj, kryetari i Kongresit u zgjodh Dervish bej Biçaku nga Elbasani, nënkryetar Mithat bej Frashëri, kurse sekretarë Simon Shuteriqi dhe Josif Haxhi Mima. Sipas raportit, mytesarifi i Elbasanit ishte i pranishëm vetëm në lutjen e hapjes së Kongresit dhe menjëherë pas kësaj ishte larguar duke gjetur një pretekst<sup>11</sup>.

“Antipatia dhe mosbesimi që ushqenin xhonturqit ndaj kësaj mbledhjeje thjesht kombëtare .... për t’u shërbyer çështjeve kulturore, relatohet më tej në raportin e sipërpërmendur, ..... u tregua që në fillim kur komandanti i xhandarmërisë së Elbasanit, majori Naxhi bej, një shqiptar, që i kish dëshmuar shpesh bindjet patriotike, së fundi edhe në themelimin e një klubi shqiptar në Skrapar, papritur, me urdhërin e komandantit epror të xhandarmërisë në Manastir, u thirr nga Elbasani në Manastir”. Për më tepër, klubi xhonturk i Elbasanit, theksohet në raportin

<sup>8</sup> *Po aty*, Vj. 19.14.1485. Raport i dt. 10 shtator 1909 nga Manastiri.

<sup>9</sup> *Po aty*, Vj. 19.7.741. Relacion i konsullit të përgjithshëm Kral, nga Shkodra i dt. 14 shtator 1909; *Po aty*, Vj. 19.2.255. Raport i 14 shtatorit 1909, dërguar ministrit Erental në Vjenë nga V. Pollanz me urdhër të nënkonsullit Halla të zonës Tiranë-Durrës; *Po aty*, shih edhe Vj.19.14.1489. Raport i 18 shtatorit 1909 i Krausit nga Vlora për Erentalin në Vjenë.

<sup>10</sup> *Po aty*.

<sup>11</sup> *Po aty*, Vj.19.14.1485, Raport i 10 shtatorit 1909 i Posfai nga Manastirit për Erentalin në Vjenë.

e konsullit, është përpjekur pa sukses “për të përpunuar banorët e fshatrave përreth, që të mos i jepnin kurrëfarë rëndësie Kongresit”. Sipas konsullit, qarkullonin edhe fjalë se për këtë qëllim ishin korruptuar me nga dy mexhide ryshfet fshatarë me influencë, që të ndikonin te të tjerët<sup>12</sup>.

Në raportet konsullore të shtator-tetorit 1909, theksohet se Kongresi mori vendime për tre çështje themelore, e përkatësisht për çështjen e themelimit të një shkolle pedagogjike, për krijimin e një qendre për drejtimin, organizimin dhe financimin e shkollave shqipe dhe për masat për bashkërendimin e veprimtarisë së klubeve shqiptare. “Menjëherë Kongresi kaloi në diskutimin e çështjes së shkollave, theksonte konsulli i Manastirit, Posfai, sepse pika e tij më e rëndësishme ishte ngritja e një shkolle pedagogjike për përgatitjen e mësuesve”. Për hartimin e programit të kësaj shkolle, që më pas u miratua nga Kongresi, u zgjodh një komision prej shtatë vetësh i përbërë nga (Qemal bej Vrioni, Grigor Cilka, Gjergj Qirjazi, Mithat bej Frashëri) dhe tre elbasanas, përkatësisht Emin Efendiu, Simon Shuteriqi dhe Josif Haxhi Mima<sup>13</sup>.

Në raporte jepej informacion i detajuar për programin e Shkollës Normale, që do të krijohet, për këshillin mbikqyrës (me tetë anëtarë) të zgjedhur çdo dy vjet nga qytetarë elbasanas, për shpërblimin e personelit mësimor, për mënyrën e sigurimit të mjeteve financiare etj. Sipas të dhënave në raporte, vendi i drejtorit iu propozua Luigj Gurakuqit, i cili e pranoi këtë detyrë<sup>14</sup>. Më tej, në to theksohet se kongresistët miratuan që Këshilli Mbikqyrës për të ndihmuar nxënës të merituar, do të dispononte 100 lira në vit, se konviktorët do të paguanin për strehim e ushqim 10 lira në vit etj. Ishte interesant përcaktimi nga Kongresi se, nxënësit e strehuar dhe të ushqyer pa pagesë në konvikt, pas diplomimit ishin të detyruar të shërbenin si mësues në Shqipëri për 3 vjet (me pagesë).

Sipas informacioneve të konsujve a-h, Kongresi vendosi që, për nxënësit nga sanxhaku i Elbasanit, në internatin e shkollës do të rezervoheshin  $\frac{1}{4}$  e vendeve, e nëse kapacitetet nuk plotësoheshin nga të tjerët, edhe më tepër.

<sup>12</sup> Po aty.

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Po aty. Relacion i kryekonsullit Kral nga Shkodra dt. 14 shtator 1909 për ambasadorin e jashtëzakonshëm të A-H në Stamboll, Eduard Otto dhe ministrin e Jashtëm Erental në Vjenë; Po aty, Vj.19.13.1399, Raport rezervat nga Manastiri i konsullit Posfai, dt. 12.XII.1909, për Erentalin në Vjenë.

Detajohej edhe programi mësimor i shkollës që parashikonte 30 lëndë mësimore<sup>15</sup>:

Konsulli i Manastirit Posfai, por edhe të tjerë, në raportet e tyre nënvizonin debatin e zhvilluar në Kongres, për të futur ose jo, në programin mësimor gjuhën greke. Fillimisht, ajo nuk ishte parashikuar të përfshihej në programin e hartuar nga komisioni, por u pranua të futej si lëndë fakultative pas diskutimit të Idhomene Kosturit, që theksoi

<sup>15</sup> *Po aty*, Vj. 19.14.1485. Shtojca II e raportit të 10 shtatorit 1909 nga Manastiri.

#### **Programi shkollor i shkollës Normale në Elbasan**

Komisioni i ngarkuar nga Kongresi, me themelimin e Shkollës Normale në Elbasan, ka hartuar programin e mëposhtëm:

1. Shkolla normale ma gjashtë klasë është nën kontrollin e një Këshilli Mbikqyrës, i përbërë nga 8 anëtarë që do të zgjidhet njëherë në dy vjet e në të cilin kanë të drejtë të bëjnë pjesë qytetarë elbasanas.
2. Zgjedhja e këshillit mbikqyrës bëhet nga klubet (2) e shoqëritë (2) shqiptare elbasanase që në lidhje me këtë caktojnë komisione.

Këshilli mbikqyrës dhe drejtori i institucionit janë të ngarkuar bashkërisht me drejtimin e shkollës, përkatësisht përgjegjës për rezultatet që synon të arrijë shkolla.

2. Drejtori merr një rrogë të përvitshme prej 150 funta. Të ardhurat e personelit mësimor, 6 profesorë, arrijnë në 550 funte dhe pikërisht tre profesorë marrin 300, kurse 3 të tjerë vetëm 250 funte në vit.

Për qiranë e godinës ku do të strehohet shkolla, për pagesën e dy shërbëtorëve të shkollës, pastaj për shpenzime të ndryshme, e të paparashikuara, do të caktohen nga 50 funte, që bëjnë së bashku 200 funte.

3. Këshilli mbikqyrës disponon një shumë prej 100 funte në vitn që e përdor me qëllim që të ndihmojë nxënës ose kandidatë që meritojnë të merren në konsideratë.
4. Nxënësit që duan të strehohen e të ushqehen në shkollë (në internat) duhet të paguajnë çdo vit për shpenzime ushqimi e fjetje 10 funte. Sidoqoftë, Këshilli Mbikqyrës është i lirë të miratojë një ulje, kufizim të kësaj pagese ose edhe të heqë dorë krejtësisht nga pagesa e këtyre parave duke paguar ndryshimet ose dhe të gjithë shumën e parave me anën e fondit prej 100 funte të caktuar në pikën 3.
  - a) Nxënësit që janë të çliruar krejtësisht në pagesa e shpenzimeve për ushqim e fjetje, janë të detyruar që mbasi të përfundojnë studimet në shkollë të punojnë 3 vjet me pagesë si mësues në Shqipëri.
5. Nxënësit që vijnë nga Elbasani ose edhe nga sanxhaku me të njëjtin emër kanë të drejtë që të zenë një të katërtën e vendeve ekzistuese në internatin e shkollës e në qoftë se ka vetëm pak kandidatë të tjerë, edhe në shumë vende.

rëndësinë e saj për t'u dhënë mundësinë shumë të rinjve, të cilët vinin nga shkolla greke, të hynin në shkollën pedagogjike e të përdroreshin më pas si mësues<sup>16</sup>.

“Komisionit të lartpërmendur, të plotësuar me Haxhi Beun, Ahmet Daklin, Idhomene Kosturin dhe Emin Haxhi Ademin, shënohej më tej në raportet konsullore, iu besua hartimi i një projekti për *themelimin e një shoqërie shkollore*”. Kjo do të themelohej në Korçë dhe do të njihej nga qeveria si person juridik, që të mund të zotëronte “pasuritë e shumta të lëna me testament për qëllime kulturore shqiptare”<sup>17</sup>.

Konsulli Posfai raportonte se “shuma e përvitshme prej njëmijë lirash e caktuar për mbajtjen e shkollës..., respektivisht shtatëqind lira për vitin e parë, e cila, do të sigurohej me anë të ndihmave”, filloi të realizohej qysh ato ditë të Kongresit. Kontributet e atyre viteve siguruan shumë prej 563 lira<sup>18</sup>.

Në raport përmendet edhe fakti, se shqiptari i pasur me banim në Bukuresht, Kristaq Naum Dogani, në një telegram drejtuar Kongresit, lidhur me ngritjen e shkollave shqiptare, premtonte një ndihmë bujare<sup>19</sup>.

Në raportet konsullore të kohës, në mënyrë të detajuar në atë të 10 shtatorit, dërguar Vjenës nga Manastiri, nuk mbeteshin pa përmendur dhe përbërjet e *Këshillit Administrativ të shkollës pedagogjike të Elbasanit dhe Komisionit për hartimin e rregullores për “lidhjen e bashkimit” e të gjithë klubeve shqiptare*. Aty shënohej se, në të parin bënin pjesë tetë anëtarë, përkatësisht Emin Haxhi Ademi, Taqi Buda, Hysen Ceka, Lef Nosi, Dervish bej Biçaku; Ahmet Dakli, Dhimitër Papakristo dhe Petro Dodbiba, të gjithë elbasanas, kurse në të dytin 8 anëtarë të tjerë, përkatësisht Mithat bej Frashëri, Grigor Cilka, Kristo Dako, Simon Shuteriqi, Kahreman bej Vrioni, Gjergj Qiriazhi, Teki bej Leskoviku dhe Hamdi Bej Ohri, ndër të cilët, sikurse shihet njëri S. Shuteriqi ishte elbasanas<sup>20</sup>.

Është interesant të përmendet se në raportet konsullore të sipërcituara, disa nga pjesëmarrësit në Kongres, ose të caktuar për themelimin dhe drejtimin e Shkollës Normale, përgojoheshin ose shiheshin me dyshim, natyrisht nisur nga interesat thelbësore të Austro-

<sup>16</sup> *Po aty*. Vj. 19.14.1485. Raporti i 10 shtatorit 1909 i Posfai nga Manastiri.

<sup>17</sup> *Po aty*. Shih edhe Vj. 19.2.255. Raport nga Tirana-Durrësi i V. Pollanz.

<sup>18</sup> *Po aty*. Vj. 19.14.1485. Raport i 10 shtatorit 1909 nga Manastiri.

<sup>19</sup> *Po aty*.

<sup>20</sup> *Po aty*.

Hungarisë në rajon. Në këtë kontekst përmendej emri i Mithat bej Frashërit, i cili në banketin e organizuar në mbrëmjen e fundit të Kongresit, ishte prononcuar hapur kundër Austro-Hungarisë duke thirrur shumë herë “Poshtë Austria”<sup>21</sup>, gjithashtu Luigj Gurakuqi, i caktuar drejtor i Normales, por me dyshim shihej edhe Aleksandër Xhuvani, që kishte kryer studimet në Itali<sup>22</sup>.

Akti themelor i Kongresit të Elbasanit, përkatësisht *vendimet e përmbledhura në 15 pika* apo nene sipas konsujve, u miratua dhe u nënshkrua nga të gjithë delegatët.

Në nenin 10, në një raport të 14 shtatorit, relatonte nga Durrësi V. Pollanz, theksohej se “ftoheshin shqiptarët që të ndërhyjnë bashkë me këshilltarët e administratës së vilajeteve për themelimin e shkollave bujqësore në një vend të përshtatshëm”. I rëndësishëm, sipas këtij raporti, ishte dhe pika apo neni tjetër, që “u rekomandon të gjithëve” të shkruanin duke përdorur “dialektin e Elbasanit, pasi ky kuptohet kudo”<sup>23</sup>.

Së fundi, ai theksonte se “u vendos që të gjithë klubet, të vepronin së bashku, kur do të ishte rasti për të mbrojtur interesat kombëtare” (neni 13) dhe “pas tre vjetësh, të mbledhesh përsëri një kongres në Elbasan, thirrja e të cilit, si edhe caktimi i programit, u ngarkohej klubeve dhe shoqërive të Elbasanit”<sup>24</sup>.

Raporti i 14 shtatorit i nisur nga Durrës-Tirana prej V. Pollanzit, informonte më tej, se pjesëmarrësit në Kongresin e Elbasanit kishin shqyrtuar edhe “çështje politike” për të cilat nuk qe shënuar “asgjë në protokoll”. Kështu, ishte “diskutuar me gjallëri” çështja e krijimit të një

<sup>21</sup> *Po aty*. Sipas konsullit ndër rreth 50 të pranishëm vetëm 10-12 persona e kishin miratuar thirrjen e Mithat Frashërit, e cila ishte bërë në fund të një “fjalimi patriotik” të Dom Nikoll Kaçorrit, që pasi kishte vlerësuar meritat e patriotëve të mirë dhe kish dënuar mënyrën e veprimit të regjimit të vjetër kundër shqiptarëve në fund të fjalës së tij, ishte shprehur se kishte akoma të tjerë që qëndronin “nën maskën e miqësisë e të paraqitjes si përkrahës të regjimit të ri” por që “nuk ia kishin me sinqeritet kombit shqiptar”.

<sup>22</sup> *Po aty*. Shih edhe Vj.19.6.657. Raport i konsullit Bilinski nga Janina, dt. 21 tetor 1909 për Erentalin në Vjenë; shih edhe *po aty*, Vj. 19.2.255, Raport i 14 shtatorit 1909 dërguar nga Tiranë-Durrës prej V. Pollanz për kontin Erental në Vjenë; *Po aty*, Vj. 19.13.1399. Raport rezervat i Posfait nga Manastiri, dt.12 dhjetor 1909 për ministrin Erental në Vjenë.

<sup>23</sup> *Po aty*. Raporti i 14 shtatorit 1909 i V. Pollanz.

<sup>24</sup> *Po aty*.

“kishe kombëtare shqiptare” për t’i shkëputur ortodoksët shqiptarë nga Patrikana, çështje kjo e mbrojtur më gjallërisht nga shqiptarët protestantë të Korçës, por që u konsiderua jashtë kompetencave të Kongresit dhe e parakohshme, “sepse, sikurse ishte thënë, sot nuk mund të ekzistonte një kishë indipendente ortodokse pa një influencë të huaj”. Edhe propozimi tjetër i protestanëve korçarë që në Institutin Pedagogjik të mos jepej mësimi i fesë, shënohej në raport, “nuk gjeti shumicën e nevojshme”<sup>25</sup>.

Së fundi, V. Pollanzi, shënonte se Kongresi kish vendosur “të protestonte” me telegram te Veziri i Madh që “të ndalej persekutimi i patriotëve shqiptarë të Vlorës”, si edhe “hartoi edhe një mesazh devocioni për Sulltanin” ku flitej për luajalitetin e shqiptarëve dhe kërkohet “përkrahja e përpjekjeve të tyre kombëtare”<sup>26</sup>.

V. Pollanz, ndryshe nga Posfai, konsulli i Manastirit i cili tregohej skeptik për vjeljen e shpejtë të fryteve të Kongresit, sepse, sipas tij, vënia në jetë e vendimeve, veçanërisht për sa i përket themelimit të menjëhershëm të shkollës pedagogjike, do të ndeshte në “vështirësi të mëdha të karakterit material”, shprehet se vendimet e Kongresit duheshin konsideruar një përparim i vërtetë dhe se në Durrës e në Tiranë “ato u aprovuan unanimisht prej të gjithë patriotëve”. Ai shton se “delegatët ishin të entuziazmuar nga mikpritja në Elbasan dhe nuk lodheshin së lëvduari interesimin e popullsisë ndaj Kongresit, madje edhe të shtresave më të ulta të popullsisë”<sup>27</sup>.

Në pjesën e fundit të raportit të 10 shtatorit 1909, të Posfai, nga Manastiri shkruhet edhe për një aspekt të rëndësishëm të karakterit politik të konstatuar më së forti gjatë ditëve të Kongresit. “Vlen të theksohet, shprehet ai, se qëndrimi i theksuar armiqësor, që tregojnë shumica e shqiptarëve ndaj regjimit të xhonturqve”, nuk u shfaq hapur gjatë Kongresit “veçse nga hapat e matura të delegatëve më të kujdesshëm e më të moderuar”<sup>28</sup>.

Sipas konsullit Posfai, për shqiptarët ishte bërë e qartë, se qëndrimi miqësor i xhonturqve ishte vetëm në dukje, sepse Komiteti Qendror i tyre nuk linte rast pa nxitur kudo komitetet lokale që “t’u kundërviheshin e t’i pengonin përpjekjet e shqiptarëve”. Pikërisht, për këtë arsye,

<sup>25</sup> *Po aty.*

<sup>26</sup> *Po aty.*

<sup>27</sup> *Po aty*, Vj. 19.14.1485. Raporti nga Manastiri i 10 shtatorit 1909.

<sup>28</sup> *Po aty.*

shqiptarët në rastin e organizimit të Kongresit të Elbasanit kishin ndeshur shumë vështirësi në Strugë, Tiranë, Gjirokastrë e vende të tjera<sup>29</sup>.

Në paragrafin e fundit të raportit, konsulli shkruan se, sipas të thënave që i kishin mbërritur atij, “bejlerët e Elbasanit, e para së gjithash Dervish (Biçaku – M.V.) pothuajse hapur, janë shprehur, se kombi shqiptar, në qoftë se qeveria e sotme nuk njeh aspiratat e tij të drejta për ruajtjen e pavarësisë (në kuptimin për t’i siguruar autonominë -M.V.) dhe përpiqet ta shtypë, do të gjejë rrugëdalje në dhunën e hapur, [domethënë] do të ishte i detyruar të rrëmbente armët”<sup>30</sup>.

Kjo pjesë e fundit e raportit është shumë e rëndësishme për të kuptuar frymën që mbizotëronte në Elbasan dhe, jo vetëm atje, atë vjeshtë të vitit 1909. Ai plotësohet me të dhëna të raporteve që pasojnë hapjen ceremoniale të Shkollës Normale më 1 dhjetor 1909. Në raportin rezervat të Posfait, të 12 dhjetorit 1909, dërguar ministrit Erental në Vjenë, theksohet se në “ceremoninë e inaugurimit solemn” të shkollës “kishin ardhur autoritetet, bejlerët dhe klubet e ndryshëm me përjashtim të atij xhonturk”<sup>31</sup>.

Për periudhën në vazhdim të fundvitit 1909, në korrespondencën e përfaqësive diplomatike austro-hungareze, flitet për zhvillime pozitive të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në drejtim të arsimit e kulturës dhe në trevat ku deri atëherë xhonturqit ia kishin dalë disi të nxirrin pengesa, duke propaganduar fenë dhe alfabetin arab. “Në veprimtarinë përkohësisht të fshehtë të grupit ekstrem nacionalist [këtu] shprehej më 16 dhjetor konsulli Adamkieviç nga Shkupi, duket se po shprehet qartë ideja e unitetit shqiptar ... dhe tendenca ... e lidhjeve më të ngushta ndërmjet gegëve dhe toskëve”<sup>32</sup>. Sipas konsullit, domethënës ishte fakti se klubi i Shkupit, sipas udhëzimeve të klubit qendror të Manastirit,

<sup>29</sup> *Po aty.*

<sup>30</sup> *Po aty.*

<sup>31</sup> *Po aty*, Vj.19.13.1399. Raport rezervat i Posfait nga Manastiri për kontin Erental në Vjenë. Konsulli informon për numrin e nxënësve të fillimit (27 ose 40, sipas të dhënave të ndryshme) për emrat e 6 profesorëve të parë të shkollës Luigj Gurakuqi – drejtor, Aleksandër Xhuvani, Pertef Biba nga Elbasani; Petri nga Korça si dhe mësuesi i muzikës dhe gjimnastikës në shkollën e atjeshme greke, Papa Kristo.

<sup>32</sup> *Po aty*, Vj. 19.6.628, Raport i konsullit Adamkieviç nga Shkupi, dt. 16 dhjetor 1909 për kontin Erental në Vjenë.

kishte dërguar në Normale, konviktorë nga Prizreni, Gjakova, Mitrovica, Vuçiterni dhe Shkupi<sup>33</sup>.

Të gjithë faktet e relatuar nga konsujt austro-hungarezë të kohës, dëshmojnë më së miri se shqiptarët po bënë hapa të shpejta përpara për të finalizuar aspiratat e tyre kombëtare. Kongresi i Elbasanit dhe vendimet e tij shumë të rëndësishme, të finalizuara në kohë rekord, duke filluar me hapjen e Shkollës Normale, pikërisht 100 vjet më parë, tregonin se në këtë ecuri ky qytet dhe periferia e tij po shfaqeshin si një pikë kyçe e me mjaft peshë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, rol që elbasanasit do ta luanin fuqishëm edhe në vitet pasuese, kur u siguroa pavarësia dhe hidheshin hapat për konsolidimin dhe demokratizimin e shtetit shqiptar dhe, natyrisht, hapat për arsimimin dhe emancipimin kombëtar.

Rreth 100 nxënësit e parë, nga të cilët gjysmat ishin elbasanas, do të kishin shumë shpejt pranë edhe dhjetëra nxënës nga të gjitha trevat shqiptare, shumë prej të cilëve nga Kosova dhe treva të tjera shqiptare lindore. Një e dhënë e gazetës “Tomorri”, dt. 24.3.1913, bën fjalë për 111 nxënës, nga të cilët 33 vinin nga Kosova dhe trevat shqiptare lindore, përkatësisht nga Peja, Gjakova, Mitrovica, Prizreni, Shkupi, Struga, Dibra, Gjilani, Vuçiterni e Presheva<sup>34</sup>. Statistika e mësipërme

<sup>33</sup> *Po aty.*

<sup>34</sup> Gazeta “Tomorri”, 24.3.1910; Shih edhe gaz. “Bashkimi i Kombit”, 25.3.1910 që bën fjalë për 19 djem që po vinin në Normale nga “Kosova e Struga” si edhe gazeta “Tomorri” 10 korrik 1910, që bën fjalë për 38 nxënës që po vinin nga “viset e Shqipërisë së Sipërme”. Në gazetën “Tomorri” dt. 24.3.1910, shkruhej:

Numuri i nxanësve të Shkollës Normale sipas qyteteve që kanë ardhur:

Nxanësit e shkollës Normale sipas qyteteve që kanë ardhur dahan kështu:

Elbasan .....	50	Picaar.....	1
Tiranë.....	4	Përmet .....	3
Berat.....	1	Libohovë.....	3
Peqin .....	1	Strugë .....	1
Cpat.....	6	Dibrë.....	7
Gjirokastër.....	2	Starovë .....	2
Pejë.....	1	Shkodër.....	2
Jakovë .....	3	Krujë.....	1
Mitrovicë.....	3	Kavajë.....	1
Prizren .....	2	Gjilan.....	5
Ysqyp.....	4	Vuçeternë .....	5
Delvinë.....	1	Precove.....	2

Nxanësit sikurse e shohim ne mos lathitemi, ne shenimt që kemi marrun, janë sivjet gjithë, gjithë, njëqind e njëmbëdhjetë. Nga zemra desherojmë motin që vjen të shtohen dhe të shumohen për me i deftyemun kështu botës se sa dijmë edhe ne të

dëshmon qartë se nxënësit e ardhur në Elbasan nga trevat shqiptare veriore përbënin një shumicë të konsiderueshme. Dhe ata vinin pikërisht nga ato vise ku xhonturqit arritën të pengonin dërgimin e delegatëve në Kongresin e Elbasanit, çka tregon se Lëvizja Kombëtare Shqiptare nuk mund të ndalej më.

Elbasani kishte meritën e veçantë për këtë sukses<sup>35</sup>.

**Numri i nxënësve të Shkolës Normale si pas qyteteve që kanë ardhur.**


çemojmë vlerën e randësien e ditunis, dhe se sa na mallënjehet zemra e na kënaqet shpirti, kur shohim që kombi i ynë me çapa të sigurta po udhëton në rrugë të përparimit dhe të qytetënis së vërtetë.

<sup>35</sup> Sipas një botimi përkujtimor të vitit 1979, të titulluar “Shkolla e mesme Pedagogjike “Luigj Gurakuqi” Elbasan, 1909-1979”, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë: 1979, f. 5 deri në vitin 1944 në Normalen e Elbasanit ishin diplomuar 997 nxënës, kurse në vitin 1979 numri kish arritur në 6454 të diplomuar.

**Nxënset e Shkolës Normale si pas  
qytëtevet që kanë ardhur dëshmitarë:**



Elbasan	50
Tiranë	4
Berat	1
Peqin	1
Çpat	6
Ginokastrë	2
Pejë	1
Jakovcë	3
Mitrovicë	3
Prizren	2
Ysqyp	4
Delvine	1
Picaar	1
Permet	3
Libhove	3
Strugë	1
Dibrë	7
Starovcë	2
Çkodrë	2
Krujë	1
Kavajë	1
Gjalë	5
Vuçeternë	5
Preovcë	2

Nxënset, sikurse eohim, në nos  
laditemi, në cenimt që kemi marrun,  
jane sivjetë pëde, pëde që qint e qe-  
meðete. Nga zemra deerojme motin  
që vjen të etohen dhe të eumohen për  
me i deftyemur këtë botes së sa dij-  
me eadë në të çemojme vlerën e rade-  
sien e ditunis, dhe se sa na maldëhet  
zemra e na kenaqet epirti, kur eohim  
që kombi i-ynë me çapa të-sigurta po  
uadeton në rrugë të përparimit dhe të  
q' letenies së-vertete.




*Luigj Gurakuqi  
dhe Aleksandër  
Xhuvani rrugës  
nga Durrësi në  
Elbasan për  
hapjen  
e shkollës  
Normale*

*Nxënësit e  
vitit 1909*




*Godina  
e shkollës,  
1909*



*Delegatë të Kongresit të Elbasanit*



*Trupi mësimor së bashku me disa miq të shkollës Normale të Elbasanit*



Vendime të Kongresit të Elbasanit

Ndihma për ekolën Normale q u mblojë në Elbasan.	
Klubet	lira
Kozan	6
Fraçeri	18
Seleniku dhe karafërja	16
Katerina	10
Filati	10
Korça	50
Permeti	5
Struga	2
Iskoviqi	15
Skrapari	12
Peqini	4
Klub Bae. i Elbasanit	25
Klubi Vlazni i Elbasanit	25
Manastiri	25
Ginokastrë	20
Bërati	20
Starova	8
Dibra	6
amci	1
Bukuresti me anën e Korrçes	36
Gazeta Lirija	2
Gazeta Baekim' i Kombit	4
Gjoçeria Afr. Dita Elbasan	4

*Klubet shqiptare ndihmuan me të holla për hapjen e shkollës "Bashkimi i Kombit", 10.9.1909*

## Vendimet të KONGRESIT TË ELBASANIT

Delegatët të dërguarë nga an' e klubeveve dhe Shoqëritë Shqiptare që pënden brënda dhe jashtë Shqipërisë u mbledhën që më 20 për më 28 Gusht 1909 (1325) dhe vendosën:

1en.) Të fillonet dhe të nisët këto vjeshtë në Elbasan një mësonjëtorë për mësonjës me gjashtë rjeshta për të përmbajturit e së cilës janë detyruarë tërë klubet dhe shoqëritë brënda dhe jashtë Shqipërisë sikundër dhe tërë njerëzit që dësherojnë përparimn' e kombit Shqiptar.

Kur tërë rjeshtat e skollës si dhe numur mësonjësve do të jenë të plotta atë herë duhenë për të përmbajturit e shkollës 1000 lira; por sot për sot në njëse, shkolla munt të përmbahet me 700 lira.

Kongres' i Elbasanit vendosi dhe usua pikë pas të cilave do të qeveriset kjo shkollë të cilat pika janë botuarë në një vullë të veçantë.

2en.) U vendos që të fillohet një Shoqëri qendrale në Korçë me emërin "Përparimn' e cila do të njihetë prej Mbledhjes Kombit si personë morale dhe juridike dhe e cila do të jetë arka e përgjithëshme ku do të mbledhen tërë të hollat që do të dërgojnë klubet, Shoqëritë sidhe gjithë miredashësit e kombit Shqiptar.

Kjo shoqëri do të perkujdeset pak së pari që të përmbanjë mësonjëtorë për mësonjës në Elbasan, edhe do të ndihnjë me sa t' i mundet të tëra shkollave Shqip. të cilat nuku mundin të përmbahen plotërisht prej atyreve që i kanë çelur; edhe do të ndihnjë që të shtypnë libra shkollare të veçjera dhe të nevojshme, pasi të arrijtonen prej një komisioni të vendësve prej kesaj shoqërie.

*Vendimet e Kongresit të Elbasanit publikuar në gazetën "Bashkimi i kombit", 10.9.1909*